



---

REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

---

**PROGRAM ORIENTUES PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR TË  
MATURËS SHTETËRORE**

**(për gjimnazet me kohë të shkurtuar dhe për shkollat artistike dhe sportive me sistem 4-  
vjeçar)**

**LËNDA:**

**GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI**

**(provim i detyruar)**

**Viti shkollor 2018 – 2019**

	<b>Emër Mbiemër</b>	<b>Pozicioni</b>	<b>Data</b>	<b>Nënshkrimi</b>
<b>Koordinoi:</b>	E. Koleci	Specialist i Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Standardeve	25.01.2019	
<b>Pranoi:</b>	D. Rapti	Drejtori i Drejtorisë së Kurrikulës, Standardeve dhe Kualifikimit	25.01.2019	

## I. HYRJE

Lënda “Gjuhë shqipe dhe letërsi” është provim i detyruar i Maturës Shtetërore për të gjithë nxënësit që mbarojnë arsimin e mesëm të lartë. Për këtë, ata i nënshtrohen një testimi, në përbërje të të cilit janë njohuritë dhe aftësitë e fituara në këtë lëndë gjatë gjithë viteve të shkollës së mesme (klasat 10-13).

Ky testim zhvillohet mbi bazën e programit orientues. Programi orientues mbështetet në:

- programet e gjuhës shqipe dhe të letërsisë për shkollat e mesme;
- udhëzimin e MASR-së “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore”.

Programi orientues i lëndës “Gjuhë shqipe dhe letërsi” përfshin njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të kësaj lënde. Ai përbën një dokument të vlefshëm:

- për nxënësit e shkollave të mesme artistike, sportive, profesionale dhe gjimnazeve me kohë të shkurtuar;
- për mësuesit e gjuhës shqipe dhe të letërsisë;
- për specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimet e Maturës Shtetërore.

Programi orienton nxënësit për njohuritë dhe aftësitë kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses testimin në Maturën Shtetërore.

Ky program gjeneron informacionin e nevojshëm për mësuesit që do të përgatitin maturantët për provimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në Maturën Shtetërore.

Programi përbën, gjithashtu, një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga specialistët e përfshirë në hartimin e testit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë për Maturën Shtetërore.

## II. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

Programi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë nuk paraqitet me tema mësimore, por me objektiva (*për pesë aftësitë që kanë të bëjnë me format e ndryshme të ligjërit, si: të lexuarit, të shkruarit, të folurit të dëgjuarit, të vështruarit*), të cilat e vënë theksin në rezultatet e të nxënësit. Objektivat e programit të lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë realizohen nëpërmjet **teksteve** (*teksti tregimtar, teksti poetik, teksti dramatik, teksti bindës/argumentues, teksti përshkrues, teksti shpjegues, teksti informativ, teksti eseistik, teksti kulturologjik*). Fakti që nxënësi përballë dhe ushtrohet në tekste të ndryshme, e bën më të lehtë “transferimin” dhe përdorimin e koncepteve, njohurive, aftësive edhe në tekste të tjera.

**Kështu, testi i Maturës Shtetërore do të ketë në përbërje dy fragmente nga tekste të ndryshme** (tekst tregimtar, tekst poetik, tekst dramatik, tekst bindës/argumentues, tekst

përshkrues, tekst shpjegues, tekst informativ, tekst eseistik, tekst kulturologjik), **jo patjetër të punuara në klasë;**

Maturanti testohet për aftësitë intelektuale të vëzhgueshme dhe të matshme, të synuara nga programi dhe të zhvilluara në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë, të tilla si:

- aftësia për të identifikuar dhe për të kuptuar (nivel bazë i aftësive intelektuale);
- aftësia për të analizuar dhe zbatuar (nivel mesatar i aftësive intelektuale);
- aftësia për të vlerësuar, për të gjykuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë i aftësive intelektuale).

**Përqindja e pikëve në test për secilin nivel do të jetë:**

Nivelet e aftësive intelektuale		
Niveli bazë	Niveli mesatar	Niveli i lartë
40%	40%	20%

**Struktura e testit do të jetë:**

- **Pjesa e parë:** tekst letrar (45%)
- **Pjesa e dytë:** tekst jo letrar (55%)

Kjo do të thotë që në përgatitjen e maturantëve për provimin e Maturës Shtetërore, do të punohet për përvetësimin e aftësive dhe teknikave zbuluese, shpjeguese, zbatuese, analizuese, sintetizuese dhe vlerësuese. Këto aftësi dhe teknika nxënësit do t'i demonstrojnë dhe do t'i zbatojnë në tekste tregimtare, poetike, dramatike, bindëse/argumentuese, përshkruese, shpjeguese, informative, eseistike, kulturologjike, **të punuara apo të papunuara më parë në klasë.**

***Pra, nxënësit duhet të aftësohen për objektivat e programit orientues. Ata duhet të jenë të aftë të demonstrojnë arritjet e tyre në të gjitha llojet e teksteve.***

### III. OBJEKTIVAT E PROGRAMIT ORIENTUES SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE

#### TË LEXUARIT

Nënlinja	Objektivat
<p><b>Njohuritë mbi fjalën</b></p> <p>a) Të kuptuarit dhe përdorimi i drejtë i kuptimit të fjalës.</p> <p>b) Interpretimi dhe vlerësimi i kuptimeve të figurshme të fjalëve.</p>	<p><b>Nxënësi është i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbulojë origjinën e fjalës si një mjet për të kuptuar domethënien e tekstit;</li> <li>- të interpretojë kuptimet e figurshme të fjalëve si pasuri e shprehjes artistike në një tekst letrar;</li> <li>- të vlerësojë kuptimet e figurshme të fjalëve si pasuri e shprehjes artistike në një tekst.</li> </ul>
<p><b>Strategjitë e të lexuarit</b></p> <p>a) Përdorimi i strategjive të të lexuarit për të kuptuar një tekst.</p> <p>b) Identifikimi i veçorive të teksteve.</p> <p>c) Evidentimi i veçantive të llojeve të ndryshme të teksteve dhe krahasimi mes tyre.</p> <p>d) Zbulimi dhe vlerësimi i pozicionit të autorit.</p>	<p><b>Nxënësi është i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbatojë strategji të tilla të të lexuarit si: strategjia e hartës së tekstit, e problem-zgjidhjes, e përmbledhjes dhe e diagramit të Venit;</li> <li>- të përdorë informacionin e tekstit për të zbuluar nëntekstin dhe për të nxjerrë përfundime;</li> <li>- të parafranojë informacionin e marrë nga tekste të llojeve të ndryshme;</li> <li>- të bëjë përmbledhjen e një teksti;</li> <li>- të zbulojë tipare të përbashkëta dhe dalluese ndërmjet teksteve të ndryshme në lidhje me: personazhet, temën, problem-zgjidhjen, lidhjen e ndërmjetme dhe relacione të tjera;</li> <li>- të vlerësojë stilin e autorit në tekste të ndryshme.</li> </ul>
<p><b>Pasurimi i fjalorit</b></p> <p>a) Zbulimi dhe përdorimi i dukurive gjuhësore si: polisemia, homonimia, sinonimia, antonimia, shprehjet frazeologjike.</p>	<p><b>Nxënësi është i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë gjerësisht dhe me efikasitet dukuritë semantike, si: polisemia, homonimia, sinonimia, antonimia;</li> <li>- të analizojë figurshmërinë e përdorur në tekste të ndryshme, përmes burimeve gjuhësore të</li> </ul>

<p>b) Vlerësimi i figurshmërisë së përdorur në tekste të ndryshme, përmes burimeve gjuhësore të shprehësisë.</p>	<p>shprehësisë (fonetike, morfologjike, leksikologjike, sintaksore), për të pasuruar fjalorin;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të vlerësojë përdorime të gjuhës së figurshme nga tekste të ndryshme dhe vepra letrare.</li> </ul>
<p><b>Aftësitë e të kuptuarit të tekstit dhe reflektimi ndaj tij</b></p> <p>a) Përdorimi i njohurive dhe aftësive për të kuptuar tekstin.</p> <p>b) Evidentimi i rolit të fjalëve në krijimin e tonit dhe atmosferës së veprës.</p> <p>c) Interpretimi i një vepre në drejtim të arritjes artistike gjuhësore, filozofike, shoqërore e psikologjike.</p>	<p><b>Nxënësi është i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të analizojë tekstin (letrar dhe joletrar) si forma të larmishme të ligjërimit;</li> <li>- të tregojë sesi teksti pasqyron artistikisht marrëdhënie historiko-shoqërore të një periudhe kohore të caktuar;</li> <li>- të identifikojë karakteristika përmbajtjesore të teksteve (tema, tematika, motivi, karakteret);</li> <li>- të zbulojë qëndrimin e autorit ndaj “lëndës” që trajton dhe ndaj lexuesit të cilit i drejtohet;</li> <li>- të zbulojë sesi përdorimi i fjalëve të autorit krijon tonin dhe atmosferën e përgjithshme të veprës;</li> <li>- të interpretojë një vepër në drejtim të arritjes artistike gjuhësore, filozofike, shoqërore e psikologjike;</li> <li>- të zbulojë tipare të përbashkëta dhe dalluese midis një teksti të traditës letrare dhe një shkrimi bashkëkohor, duke i vendosur në marrëdhënie krahasuese.</li> </ul>

## TË SHKRUARIT

Nënlinja	Objektivat
<p><b>Shkrimi si proces</b></p> <p>a) Përfshirja në hapat e domosdoshme të procesit të të shkruarit.</p> <p>b) Njohja dhe përdorimi i elementeve të sistemit të</p>	<p><b>Nxënësi është i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përfshihet në të gjitha hapat e procesit të të shkruarit: parashkrimi, draftimi, rishikimi (redaktimi e korrektimi);</li> <li>- të përdorë elementet e sistemit të vlerësimit (ideja kryesore, nënidetë, organizimi, drejtshkrimi, fjalori,</li> </ul>

vlerësimit.	saktësia gramatikore, referencat) për shkrimin e tij.
<b>Shkrimi si produkt</b> a) Realizimi i një shkrimi për tema, qëllime dhe audiencë të caktuara. b) Përdorimi i elementeve të domosdoshme për të përfunduar një shkrim.	<b>Nxënësi është i aftë:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të shkruajë tekste me disa paragrafë duke zhvilluar një ide kryesore;</li> <li>- të përdorë gjuhë të saktë, detaje specifike, përshkrime, shembuj, përkufizime, analogji;</li> <li>- të zgjedhë fjalët dhe format gjuhësore për të shprehur ngjyrimë emocionale personale etj;</li> <li>- të përdorë stil vetjak dhe autorial për të tërhequr vëmendjen e audiencës;</li> <li>- të përdorë struktura të tilla, si: kronologjia, sekuenca, titujt, nëntitujt etj.</li> </ul>
<b>Format e shkrimit, audiencë dhe qëllimet</b> a) Demonstrimi i aftësive për të shkruar në forma të ndryshme, për një shumëllojshmëri audiencash dhe qëllimesh si dhe duke zbatuar kriteret e domosdoshme për çdo formë.	<b>Nxënësi është i aftë:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të shkruajë lloje të ndryshme tekstesh, të cilat: <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillojnë një ide;</li> <li>• kanë një organizim strukturor të përshtatshëm me qëllimin, audiencën dhe kontekstin;</li> <li>• përfshijnë informacione të rëndësishme, duke përjashtuar informacionet më pak të rëndësishme;</li> <li>• mbështesin gjykimet me të dhëna të përshtatshme e thelbësore, si dhe me detaje të përzgjedhura;</li> </ul> </li> <li>- të vlerësojë si ndikojnë mbi audiencën, elemente të tilla, si: stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajtja e këndvështrimit.</li> </ul>
<b>Drejtshkrimi dhe pikësimi</b> a) Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit dhe të pikësimit. b) Zbatimi i njohurive të gjuhës standarde shqipe.	<b>Nxënësi është i aftë:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë rregullat drejtshkrimore të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet;</li> <li>- të përdorë njohuri të gjuhës standarde për të redaktuar punët me shkrim;</li> <li>- të përdorë rregullat e pikësimit të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet e tij.</li> </ul>

#### **IV.LISTA E VEPRAVE NGA DO TË PËRZGJIDHET FRAGMENTI I TEKSTIT LETRAR NË TESTIMIN KOMBËTAR**

##### **Poezi**

Homeri “Iliada”; Populli “Këngë të epikës legjendare shqiptare”; N. Frashëri “Lulet e verës”; De Rada “Këngët e Milosaos”; Bajron “Çajld Harold”; Poradeci “Lirika”; Migjeni “Vargjet e lira”; Kadare “Ca pika shiu ranë mbi qelq”.

##### **Prozë**

Servantes “Don Kishoti”; Hygo “Katedralja e Parisit”; Koliqi “Tregtar flamujsh”; Kadare “Kronikë në gur” dhe “Prilli i thyer”; P. Marko “Nata e Ustikës”.

##### **Dramë**

Eskil “Prometeu”; Shekspir “Romeo dhe Zhuljeta” dhe “Nata e dymbëdhjetë”; Molier “Mizantropi”; Ibsen “Shtëpia e kukullës”; F. Noli “Izraelitë dhe filistinë”.